



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2025/1109**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Paneliste Individuale duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) Katrori Group SH.P.K. kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit RITENDER Furnizim me pajisje dhe materiale për Terapi Okupacionale, për DSHB dhe ISSH me numër të prokurimit: 206-25-8168-1-2-1, me 29/12/2025, mori:

### **Vendim**

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE Katrori Group SH.P.K. me nr. 2025/1109, e datës 10/11/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit RITENDER Furnizim me pajisje dhe materiale për Terapi Okupacionale, për DSHB dhe ISSH me numër të prokurimit: 206-25-8168-1-2-1.
2. Anulohet B58 Njoftim mbi vendimin e AK-se për Lot: 1 dhe Lot: 3, ndërsa për Lot: 2 të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues, ndërkaq aktiviteti i prokurimit RITENDER Furnizim me pajisje dhe materiale për Terapi Okupacionale, për DSHB dhe ISSH me numër të prokurimit 206-25-8168-1-2-1 të kthehet në rivlerësim.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

***- Faktet dhe rrethanat procedurale -***

Me 05/09/2025, Ministria e Shëndetësisë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimi për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull RITENDER Furnizim me pajisje dhe materiale për Terapi Okupacionale, për DSHB dhe ISSH me numër të prokurimit 206-25-8168-1-2-1.

Me 25/10/2025, OE Katrori Group SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 10/11/2025, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Katrori Group SH.P.K. me nr. 1109/2025 lidhur me aktivitetin RITENDER Furnizim me pajisje dhe materiale për Terapi Okupacionale, për DSHB dhe ISSH me numër të prokurimit: 206-25-8168-1-2-1.

***-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-***

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Katrori Group SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Në vazhdim Ju prezantojmë Pikat e ankesës nga ana jonë, për shkeljet e Autoritetit Kontraktues, për tenderin “RITENDER Furnizim me pajisje dhe materiale për Terapi Okupacionale, për DSHB dhe ISSH”. Me datën 20.10.2025, KATRORI GROUP SH.P.K., Prishtinë, ka pranuar Njoftimin mbi vendimin e Autoriteti Kontraktues, për procedurën e prokurimit me titull: “RITENDER Furnizim me pajisje dhe materiale për Terapi Okupacionale, për DSHB dhe ISSH”, në cilësi të tenderuesit pjesëmarrës jemi njoftuar për anulim të aktivitetit të prokurimit për Lot 1, 2 dhe 3, për mungese te ofertave te përgjegjshme dhe për eliminim me arsyetimin pa të drejtë nga gara, për shkak se kinse kemi dorëzuar Tenderin e papërgjegjshëm.

Në vazhdim KATRORI GROUP SH.P.K., Prishtinë, Ju prezanton Pikat e ankesës, për shkeljet e bëra nga ana e Autoritetit Kontraktues, gjatë vlerësimit të tenderit të lartë cekur, me rastin e eliminimit të tenderit tonë dhe anulimit të aktivitetit të prokurimit për Lot 1, 2 dhe 3 për të cilat Lote kemi dorëzuar tender të përgjegjshëm dhe të cilat Paneli Shqyrtues pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) duhet ti merr parasysh në shpjegimin dhe arsyetimin në vijim:

? Autoritetit Kontraktues, ka shkelur nenin 1 të LPP-së (Qëllimi), me rastin e eliminimit të padrejtë të tenderit të tenderuesit KATRORI GROUP SH.P.K., Prishtinë, për LOT 1, 2 dhe 3 për këtë aktivitet të prokurimit. Me këtë rast Autoriteti kontraktues nuk e ka arritur Qëllimin e paraparë në këtë aktivitet të prokurimit, si është paraparë ne nenin 1 të LPP, që e ka për obligim që siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik për vendimet e marra, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart

të shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike.

? Kompania e jonë vlerëson se me këtë rast është shkelur Neni 6 i LPP-së, (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti), sepse Autoriteti kontraktues, me vendimin e marrë për eliminimin tonë për Lot 1, 2 dhe 3 për këtë tender nuk e ka arritur Qëllimin e paraparë në këtë aktivitet të prokurimit, si është paraparë në nenin 6 të LPP –së, citojmë :

1. Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Me këtë rast Autoriteti Kontraktues, nuk ka vepruar në pajtueshmëri me Nenin 6 të LPP-së, sepse me vendimin e marrë për eliminimin tonë për këtë tender kinse kemi dorëzuar për Lot-1 për artikullin nr. 15 dhe 16 çmim shumë të ulët, Lot-3 për artikullin nr. 4 çmim shumë të ulët dhe për Lot-2 për artikullin nr. 5 dhe 11 – kinse kemi dorëzuar çmime shumë të larta., i kanë ikur obligimit që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, duke anuluar aktivitetin e prokurimit për Lot 1, 2 dhe 3 në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së.

o Tenderuesi, KATRORI GROUP SH.P.K., Prishtinë, vlerëson se me këtë rast është shkelur neni 7 i LPP-së (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi), sepse Autoriteti kontraktues, me vendimin e marrë për anulimin e aktivitetit të prokurimit për Lot 1, 2 dhe 3 dhe eliminimin tonë për këtë tender, na ka vu në pozitë të pabarabartë dhe diskriminuese me këtë veprim, sepse kompania e jonë për këtë furnizim, ka ofruar tender të përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

o Autoritetit Kontraktues, ka shkelur nenin 56 i LPP-së – Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Të gjitha kontratat publike do të jepen, sipas procedurave të themeluara për një seleksionim të tillë, dhe përmes:

1.1. së pari, vlerësimit të tenderëve dhe kandidatëve sipas kërkesave të kualifikimit të specifikuar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit sipas paragrafit 2. të nenit 51 të këtij ligji, dhe tenderëve sipas specifikimeve teknike të kërkuara në bazë të nenit 28 të këtij ligji;

1.2 së dyti, vlerësimi i tenderëve në përputhshmëri të kriterëve të vendosura në nenin 60 të këtij ligji;

3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociatë, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Është parimi themelor i rregullave të prokurimit publik që të respektohen kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe në bazë të atyre kriterëve të përzgjidhet fituesi, respektivisht është kriter bazë që kërkohet të respektohet nga Autoriteti Kontraktues. Po ashtu, është bazike që ofertat të plotësohen nga OE siç janë kërkuar nga Autoriteti Kontraktues, është në vullnetin dhe lirinë e

OE të plotësojë ofertën financiare në bazë të politikave-kalkulimeve financiare dhe përvojës që ka për këto furnizime. Duke u bazuar në këtë nen të cekur më lartë, ne mendojmë se Autoritetit Kontraktues ka dështuar në vlerësimin e tenderit tonë, duke na eliminuar pa të drejtë, kinse kemi dorëzuar për Lot-1 për artikullin nr. 15 dhe 16 çmim shumë të ulët, Lot-3 për artikullin nr. 4 çmim shumë të ulët dhe për Lot-2 për artikullin nr. 5 dhe 11 – kinse kemi dorëzuar çmime shumë të larta. Tenderi jonë i dorëzuar është eliminuar në kundërshtim me nenin 56 pika 3 pasi që është i përgjegjshëm dhe i plotëson të gjitha kërkesat në njoftimin e kontratës dhe dosjen e tenderit.

Tenderuesi, KATRORI GROUP SH.P.K., Prishtinë, ka konstatuar se Autoritetit Kontraktues gjatë vlerësimit të tenderit ka shkelur nenin 59 i LPP-së dhe nenin 40 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik - Versioni i konsoliduar, ku Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm, vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit, të cilat kërkesa tenderi i jonë, i ka plotësuar të gjitha.

Me rastin e vlerësimit komisioni vlerësues i AK na ka dërguar Letër standarde për tenderuesin e eliminuar me arsyetimin Citojmë: Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim: Tenderi juaj është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar: C) Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenin 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të kapacitetit teknik/profesional të saktësuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës,

ARSYETIM Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: Oferta juaj është papërgjegjshëm për Lot 1, 2 dhe 3, meqenëse ka çmime jo reale në disa pozicionet (në disa pozicione shumë të ultë dhe në disa shumë të larta). Komisioni vlerësues -ka konstatuar se edhe pse vlera e përgjithshme e ofertës për të katër Lotët është brenda buxhetit të përcaktuar nga autoriteti kontraktues, disa nga çmimet e ofruara në pozicione specifike të lotëve 1, 2 dhe 3 janë joreale dhe nuk korrespondojnë me çmimet aktuale të tregut dhe si i tillë mund të ndikojnë në realizimin efektiv të kontratës dhe cilësinë e furnizimeve.

Një arsyetim i eliminimit është plotësisht i pa bazuar, kundërligjor, sepse tenderi i tenderuesit KATRORI GROUP SH.P.K., Prishtinë është në pajtueshmëri me kërkesat e përshkruara në nenin 69 të LPP, pasi që AK pas dilemave për disa artikuj kërkesës për sqarimin e tenderit të datës 09.10.2025 lidhur me Katalogët-Broshurat e pajisjeve të ofruara ju kemi dorëzuar të gjitha sqarimet dhe dëshmitë që tregojnë arsyeshëm se i përmbushim kërkesat minimale të kapacitetit teknik/profesional të saktësuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës, andaj AK në mungesë të arsyetimit dhe argumenteve për eliminim të Letra standarde për tenderuesin e eliminuar, në mënyrë të pasaktë pa bazë ligjore e ka përdorë arsyetimi i eliminimit në nenin 69 të LPP-së i cili nen ka të bëjë me Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale që fare nuk qëndron një arsyetim i tillë, sepse këto kërkesa janë plotësuar plotësisht.

Tenderuesi KATRORI GROUP SH.P.K., Prishtinë, në vazhdim konstaton se komisioni vlerësues e ka bërë një vlerësim të papranueshëm dhe kontradiktor, në njërën anë theksojnë: Oferta juaj është papërgjegjshëm për Lot 1, 2 dhe 3, meqenëse ka çmime jo reale në disa pozicionet (në disa pozicione shumë të ultë dhe në disa shumë të larta).

Kurse në anën tjetër theksojnë: Komisioni vlerësues ka konstatuar edhe pse vlera e përgjithshme e ofertës për të katër Lotët është brenda buxhetit të përcaktuar nga autoriteti kontraktues, disa nga çmimet e ofruara në pozicione specifike të lotëve 1, 2 dhe 3 janë joreale dhe nuk korrespondojnë me çmimet aktuale të tregut dhe si i tillë mund të ndikojnë në realizimin efektiv

të kontratës dhe cilësinë e furnizimeve Për

Lot I Pajisje shkollore dhe librerie për DSHB te pozicioni nr. 15 dhe 16 — çmimet janë shume te ulëta.

Lot 2- Pajisje elektronike për DSHB te POZ. nr. 5 dhe nr. 11 - çmimet janë shume te larta. Lot 3- Pajisje për aktivitet fizik për DSHB te POZ. nr. 4 — çmimi është shume i ulet.

Arsyetimi i eliminimit tonë nga AK kinse për kinse çmime jo reale po ashtu është i pabazuar. AK gjatë kohës së vlerësimit ka kërkuar sqarime dhe në afatin e kërkuar Tenderuesi KATRORI GROUP SH.P.K., Prishtinë kemi kthyer përgjigjeje dhe sqarime me shkrim për të gjitha pyetjet e juaja lidhur me broshurat dhe çmimet e ofruara dhe kemi theksuar me arsytetime konkrete se ne qëndrojmë prapa këtyre çmimeve si vijon:

Për Lotit 1 për artikullin nr. 15 dhe 16, deklarimi nga AK se çmimi është shumë i ulët, nuk qëndron një vlerësim i tillë sepse çmimet e dhëna për këtë tender bazohen në politikat e brendshme të çmimeve të kompanisë, me synimin që totali i dhënë për të gjithë artikujt të ketë një bilanc pozitiv me një fitim minimal, gjithmonë duke ruajtur cilësinë dhe garancinë e furnizimeve. Ju kemi dhënë përgjigjeje se KATRORI GROUP SH.P.K., Prishtinë ka sasi te mjaftueshëm në stok madje artikuj ne disa ngjyra, pasi që këta kolltuqe na kane mbetur teprice nga një aktivitet i ngjashëm i prokurimit dhe për këtë arsye kemi vendosur çmim me te ulet dhe ju garantojmë se qëndrojmë pas ofertës tone dhe furnizimi do te jete sipas specifikave teknike ne dosjen e tenderit dhe fotografive. Nuk qëndron vlerësimi nga AK-komisioni vlerësues se këta dy artikuj 15 dhe 16 kanë çmim të ulët pasi që janë vetëm 11 % e artikujve nga gjithsej 18 artikuj për këtë furnizim dhe oferta e jonë për këtë Lot në total është brenda buxhetit të përcaktuar ashtu si është planifikuar nga autoriteti kontraktues.

Për Lotit 2 për artikullin nr. 5 dhe nr. 11, deklarimi nga AK se çmimet janë shume te larta, nuk qëndron një vlerësim i tillë, sepse ne kemi ofruar artikullin nr. 5 pajisje për aromatizim te hapësirës se mjekut ose stafit mjekësorë. Pra kjo pajisje është profesionale dhe është e dedikuar për aromatizim me arome vajore dhe është për ordianca ambiente te mjekeve ambulance spitale etj. për atë arsye ka edhe çmimin me te larte, për dallim prej aromave te zakonshme te cilat janë te dedikuara për zyre dhe ambiente private. Artikulli nr. 11 hekur për hekurosje është profesional me avull dhe me gjenerator avulli me parametra të lartë (presion 5.8 bar rezervar te ujit te veçante 1 litërsh) pra ne mungese te hapësirës ne tabelën e çmimeve në Excel për katalog është vendosur vetëm koka e hekurit, kurse me sqarime të cilat i keni kërkuar ju kemi dhëne përgjigjeje se është fjala për komplet hekurin për këtë arsye ka edhe çmim më të lartë. Nuk qëndron vlerësimi nga AK-komisioni vlerësues se këta dy artikuj 5 dhe 11 kanë çmim shumë të lartë pasi që janë vetëm 18 % e artikujve nga gjithsej 11 artikuj për këtë furnizim dhe oferta e jonë për këtë Lot në total është brenda buxhetit të përcaktuar ashtu si është planifikuar nga autoriteti kontraktues.

Për Lotit 3 për artikullin nr. 4 deklarimit nga AK se çmimi është shumë i ulët, nuk qëndron një vlerësim i tillë, sepse ky çmimi është real dhe çmim i tregut. Lehtë mund ta verifikoni edhe çmimin e tenderuesit EUROPRINT GROUP SH.P.K për këtë artikull, i cili ka ofertuar me çmim shumë më të lirë. Ky vlerësim i komisionit vlerësues, sipas mendimit të tenderuesit KATRORI GROUP SH.P.K., Prishtinë, nuk është mbështetur në prova të mjaftueshme dhe nuk ka bazë në një hulumtim apo analizë të dokumentuar të tregut, siç kërkohet me Nenin 61 të LPP-së. Për pasojë, Autoriteti Kontraktues ka dështuar të veprojë në pajtueshmëri edhe me dispozitat e këtij neni. Për këtë edhe me tender e kemi dorëzuar deklaratën me shkrim të nënshkruar dhe vulosur

me të cilën e kemi marrë përsipër, se do ti përmbushim të gjitha specifikat teknike të përcaktuara në anëxin 1 të dosjes së tenderit dhe të përshkrimi i çmimit, nëse jemi fitues të kësaj kontrate në të gjitha furnizimet do ti bëjmë 100% sipas atyre specifikave.

Tenderuesi, KATRORI GROUP SH.P.K., Prishtinë, ka konstatuar se Autoritetit Kontraktues nuk e ka zbatuar si duhet Nenin 60 të LPP-së me rastin e vlerësimit të tenderëve (Kriteret për Dhënien e Kontratës), nuk është respektuar ky nen, ku kërkohet (citojmë) : LPP në nenin 60 paragrafi 1.dhe nenin paragrafin 1.1 përcakton: 1. Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar: 1.1 tenderin ë përgjegjshëm me çmimin më të ulët:

Tenderuesi, KATRORI GROUP SH.P.K., Prishtinë, konsideron se Autoriteti Kontraktues-komisioni vlerësues ka bërë shkelje të nenit 60, sepse i njëjti e ka për detyrë të respektojë kriterin për dhënie të kontratës të kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, sipas nenit 60. paragrafi 1. pika 1.1 të Ligjit për Prokurimin Publik, që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

Tenderuesi, KATRORI GROUP SH.P.K., Prishtinë, ka konstatuar se Autoritetit Kontraktues, komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të tenderëve nuk ka vepruar në pajtueshmëri me Nenin 61 të LPP-se. Në mungesë të një hulumtimi të mirëfilltë të tregut dhe të një analize të dokumentuar, mendojmë se Autoriteti Kontraktues ka dështuar të veprojë në përputhje me dispozitat e nenit 61 të LPP-së. Eliminimi i tenderit, duke e vlerësuar ofertën tonë kinse kemi dorëzuar për Lot-1 për artikullin nr. 15 dhe 16 çmim shumë të ulët, Lot-3 për artikullin nr. 4 çmim shumë të ulët dhe për Lot-2 për artikullin nr. 5 dhe 11 – kinse kemi dorëzuar çmime shumë të larta nuk është mbështetur në prova të mjaftueshme apo krahasime të sakta me çmimet e tregut Ky vlerësim sipas neve nuk qëndron dhe është i pabazuar, sepse nga AK është shkelur Neni 61 të LPP-së me rastin e vlerësimit të tenderëve (Tenderët Jo-Normalisht të Ulët) dhe nuk janë marrë me elementet tjera të shqyrtohen, sepse nuk kemi të bëjmë me çmim Jo normalisht të ulët, sepse edhe ofertat pjesëmarrëse janë të përafërta, kurse ne jemi me çmim më të ulët. Në çdo rast, kur ka një prag për tender jo-normalisht të ulët, ndalohet përjashtimi automatik i ofertave jo normalisht të ulëta pa përdorur një procedurë inter partes me operatorin përkatës ekonomik për shqyrtimin e tenderit i cili konsiderohet nga autoriteti kontraktues si jo-normalisht i ulët. Në pajtueshmëri me Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, pas kërkesës nga ana Juaj për veç tjerash për të dhënë sqarime përmes Letrës Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit, të datës 09.10.2025 ju kemi dërguar përgjigje, shpjegim dhe argumente detale të çmimeve të ofertuar dhe elementeve përbërëse të tenderit tonë. Çmimet e dhëna për këtë tender, bazohen në Politikat e çmimeve të kompanisë KATRORI GROUP SH.P.K., PRISHTINË, me synimin që totali i dhëne për të gjithë artikujt të ketë një bilanc pozitive me një fitim minimal. Me këtë letër ju kemi konfirmuar që firma KATRORI GROUP SH.P.K., PRISHTINË, qëndron prapa çmimeve të dhëna në propozimin financiar dhe me kënaqësi do të dëshmonim profesionalizmin tonë në këtë drejtim. Ne me këto çmime, të cilat për neve janë çmime të tregut, kemi kontrata të shumta me Institucione dhe Autoritete Kontraktuese të qeverisë së Kosovës, të cilat i kemi realizuar me sukses, për çka tregojnë edhe referencat e shumta të lëshuara për realizimin e suksesshëm të këtyre kontratave, të cilat janë të bashkangjitura në këtë tender.

Sqarim plotësues për ndryshimin e arsytimit të refuzimit të kërkesës për rishqyrtim nga AK: (shkelja e nenit 108/A dhe neneve 62 dhe 63 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik - Versioni i konsoliduar) AK – Ministria e Shëndetësisë me rastin e publikimit të Vendimit të AK na ka refuzuar ofertën tonë për Lot 1, 2 dhe 3, duke e cilësuar si ofertë të papërgjegjshme, me arsytimin se “oferta përmban çmime joreale në disa pozicione (në disa pozicione shumë të

ulëta dhe në disa shumë të larta)”, për të cilat i kemi dhënë arsyetimet dhe kundërshtimet detale më lartë në këtë ankesë. Në arsyetimin e parë të dhënë me Letër standarde për eliminim, Autoriteti Kontraktues nuk ka përmendur asnjë mospërputhje teknike të ofertës tonë, sepse me sqarimet e kërkuara nga AK gjatë vlerësimit i kemi dhënë përgjigjejet në këto kërkesa për sqarime, por vetëm pretendimin për çmime joreale.

Megjithatë, në Vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim të datës 30.10.2025, Autoriteti Kontraktues ka ndryshuar arsyetimin fillestar të eliminimit, duke deklaruar tashmë se oferta jonë nuk është në përputhje të plotë me specifikat teknike të kërkuara në dosjen e tenderit, duke përmendur si shembull artikullin “aromatizues”, pa dhënë ndonjë provë apo arsyetim teknik të detajuar. Me këtë veprim AK ka bërë shkelje të nenit 108/A të LPP-së, ku çdo vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim duhet të përmbajë arsyetimin e qartë dhe të plotë, që lidhet drejtpërdrejt me pretendimet tona të cilat kanë qenë ligjore të bazuara në fakte dhe argumente. Ndryshimi i arsyetimit në fazën e shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, përveç që është proceduralisht i papranueshëm dhe në kundërshtim me nenet 62 dhe 63 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik - Versioni i konsoliduar, na ka cenuar të drejtën tonë për t’u mbrojtur në mënyrë të bazuar dhe efektive, pasi arsyeja e re nuk ishte objekt i eliminimit të datës 20.10.2025.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 11/11/2025 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1109/2025, ndërsa me datë 16/11/2025 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 1109/2025, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit për Lot: 1 dhe Lot: 3 dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim, ndërsa për Lot: 2 të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

#### ***- Administrimi dhe vlerësimi i provave –***

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrirat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Katrori Group SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/1109 ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues – Ministria e Shëndetësisë, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: “RITENDER Furnizim me pajisje dhe materiale për Terapi Okupacionale, për DSHB dhe ISSH”, me numër të prokurimit: 206-25-8168-1-2-1. Procedura e procedurë e hapur, ndërsa lloji i kontratës është furnizim.

Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit më datë 05.09.2025, në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik.

Më datë 10.11.2025, KATRORI GROUP SH.P.K., me seli në Rr. Lidhja e Prizrenit Hy 197 Nr 32, ka paraqitur ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit, duke kundërshtuar Letërn standarde për tenderuesin e eliminuar e dates 20.10.2025, si ne vijim:

## ARSYETIM

“Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Oferta juaj është papërgjegjshme për Lot 1, 2 dhe 3, meqenëse ka cmime jo reale në disa pozicionet (në disa pozicione shumë të ulta dhe në disa shumë të larta).

Komisioni vlerësues ka konstatuar se edhe pse vlera e përgjithshme e ofertës për të katër lotët është brenda buxhetit të përcaktuar nga autoriteti kontraktues, disa nga cmimet e ofruara në pozicione specifike të loteve 1, 2 dhe 3 janë joreale dhe nuk korrespondojnë me cmimet aktuale të tregut dhe si i tillë mund të ndikojnë në realizimin efektiv të kontratës dhe cilësinë e furnizimeve. Për Lot 1 Pajisje shkollore dhe librerie për DSHB të pozicioni nr. 15 dhe 16 - cmimet janë shumë të ulta. Lot 2- Pajisje elektronike për DSHB të poz. nr. 5 dhe nr. 11 - cmimet janë shumë të larta. Lot 3- Pajisje për aktivitet fizik për DSHB të poz. nr. 4 - çmimi është shumë i ulët”.

Operatori ekonomik ankues ka deklaruar se: “Në pajtueshmëri me Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, pas kërkesës nga ana Juaj për veç tjerash për të dhënë sqarime përmes Letrës Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit, të datës 09.10.2025 ju kemi dërguar përgjigje, shpjegim dhe argumente detale të çmimeve të ofertuar dhe elementeve përbërëse të tenderit tone”.

Letra Standarde për Eliminim nga Autoriteti Kontraktues ndaj Operatorit Ekonomik, i cili është bazuar në parimin e vlerësimit të ofertës lot-pas-loti. Analiza është fokusuar në nenet 60, 61 dhe 62 të Ligjit për Prokurimin Publik, si dhe në pretendimet e operatorit ekonomik ankues.

Eksperti shqyrtues ka analizuar dhe vlerësuar Lotet 1 dhe 3, në të cilat Autoriteti Kontraktues ka kërkuar përmbushjen e detyrimeve procedurale dhe substanciale, në pajtim me nenet 60 dhe 61 të LPP-së. Megjithatë, para se të refuzonte shpjegimet e operatorit ekonomik ankues, Autoriteti Kontraktues është dashur të dëshmojë me fakte konkrete (p.sh., krahasim me koston e tregut apo identifikim të mungesës së dëshmimeve nga OE) se çmimet e ofruara janë nën koston reale të realizimit dhe paraqesin rrezik serioz për ekzekutimin e kontratës. Nëse Autoriteti Kontraktues ka dështuar të argumentojë në mënyrë të saktë dhe të bazuar refuzimin e shpjegimeve të OE ankues, atëherë ai ka shkelur parimin e zbatimit të drejtë të neneve 60, 61 dhe 62 të LPP-së. Si rrjedhojë, vendimi për këto lote është i pajustificuar dhe rekomandimi ynë është që Loti 1 dhe 3 të kthehen në rivlerësim.

Eksperti shqyrtues ka analizuar dhe krahasuar Letrën Standarde për Eliminim për Lotin 2, ku eliminimi është arsyetuar me “çmime shumë të larta për njësi”. Ky eliminim i referohet statusit të ofertës si financiarisht e papërgjegjshme, në pajtim me nenin 60 të LPP-së. Arsyetimi i Autoritetit Kontraktues bazohet në çmimet e larta të ofertuara për pozicionet përkatëse (Poz. 5: çmimi për njësi është 100.00 €, dhe Poz. 11: çmimi për njësi është 230.00 €). Eksperti shqyrtues vlerëson se këto çmime për njësi, të cilat janë konsideruar të larta edhe nga komisioni i vlerësimit në krahasim me çmimet e tregut, përbëjnë bazë të mjaftueshme për eliminimin e ofertës. Prandaj, rekomandimi ynë është se vendimi i Autoritetit Kontraktues është i bazuar ligjërisht dhe të mbetet në fuqi për Lot 2.

Eksperti shqyrtues, pas analizimit dhe krahasimit të çmimeve për njësi për Lotet 1, 2 dhe 3, rekomandon që Lotet 1 dhe 3 të kthehen në rivlerësim si oferta të përgjegjshme, ndërsa për Lotin

2 të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues.

**- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –**

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues për Lot I dhe II nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit RITENDER Furnizim me pajisje dhe materiale për Terapi Okupacionale, për DSHB dhe ISSH me numër të prokurimit 206-25-8168-1-2-1.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar, ngase sipas arsyetimit nga AK -ja se çmimet e ofruara në pozicione specifike të lotëve 1, 2 dhe 3 janë joreale , AK fillimisht duhet hulumtuar tregun sikurse parashihet në nenin 4 të RrPP-se, poashtu edhe gjate vlersimit të ofertave , e në rastin konkret AK-ja lidhur me Lot I dhe III nuk ka ofruar ndonje dëshmi-provë se çmimet jane jo reale.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues ka vendosur ta mbështes raportin e ekspertit shqyrtues lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: RITENDER Furnizim me pajisje dhe materiale për Terapi Okupacionale, për DSHB dhe ISSH me numër të prokurimit 206-25-8168-1-2-1, të anulohet B58 Njoftim mbi vendimin e AK-se për Lot I dhe III dhe lenda te kthehet ne ri-vleresim, duke kërkuar që gjate rivlersimit AK të veproj në harmonni me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë. Ndërsa për Lot II mbetet sipas rekomandimit të ekspertit shqyrtues në fuqi B58 Njoftim mbi vendimi i AK-se.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II dhe III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën Iv të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.





Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Batisha Ibrahim**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E SHËNDETËSISË**
- **OE - KATRONI GROUP SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: